



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 20.02.2017, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK – 03-02-2771/16, për z. Ukshin Lushtaku – Këshilltar Komunal në Komunën e Skenderajt, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, nr. AKK – 03-02-2771/16, për z. Ukshin Lushtaku – Këshilltar Komunal në Komunën e Skenderajt, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Në këtë rast, zyrtari i lartë z. Lushtaku, është hetuar për konflikt të mundshëm interesi sepse krahas ushtrimit të funksionit publik, ka qenë person i autorizuar në bizneset private “Security Code” SH.P.K. dhe D.P.H. “Mega”.

Agjencia kundër Korrupsionit ka filluar procedurën e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit me të cilën fillimisht ka njoftuar zyrtarin e lartë me shkresë zyrtare. Më pas, z. Lushtaku është takuar me zyrtarët e Agjencisë, për t’i sqaruar situatën në të cilën ndodhet dhe për t’i dhënë rekomandimet për ndryshimet që duhet të bëj, për të shmangur situatën e konfliktit të interesit.

z. Lushtaku është bindur për kufizimin e ushtrimit të funksioneve menaxheriale në bizneset e tij private dhe menjëherë ka filluar procedurën e largimit nga ky funksion në biznesin privat “Secutiry Code”, ndërsa për biznesin privat “Mega” ka filluar procedurën e mbylljes.

Ndërkohë, i njëjti ka dërguar në Agjenci shkresën zyrtare nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë, me të cilën vërtetohet se në biznesin privat “Secutiry Code” ka caktuar një “person të besueshëm”, në cilësinë e personit të autorizuar, ndërsa për biznesin “Mega” nuk ka sjell ndonjë dëshmi për shuarjen e tij.

Prandaj, Agjencia, i ka bërë edhe shkresën e dytë që quhet “Paralajmërim” në të cilën e njofton atë për situatën në të cilën ndodhet, për masat tjera që mund të pasojnë, nëse gjendja nuk ndryshon dhe njëkohësisht i jep afat të ri, por, të kufizuar ligjor, për ta ndryshuar këtë gjendje duke shmangur konfliktin e interesit.

Ndërkohë, z. Lushtaku, brenda afatit të dhënë nga Agjencia, ka sjellë dëshminë për mbylljen biznesit “Mega”. Me këtë ai ka shmangur konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit publik.

II. Në pajtim me nenin 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së;
- Z./znj. (zyrtarit përgjegjës).



Drejtör i Agjencisë kundër Korrupsionit

Shafq Havolli